



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 108, Datë 29.03.2021

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË
DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR
KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË
SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 93, DATË 26.02.2020,
TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, mbas shortit për zgjedhjen e relatorëve,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 93, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. Alban Toro, si relator për këtë procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR